

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT KASKO

1. "OBJEKTI I KONTRATËS SË SIGURIMIT"

Siguruesi, në bazë të mbulimeve të parashikuara në këtë kontratë e çdo shtojcë të saj të nënshkruar nga palët, merr përsipër të dëmshpërblejë të Siguruarin apo përfituesin lidhur me humbjen apo dëmtimin e plotë ose të pjesshëm të mjetit motorik të siguruar, në mënyrë të papritur të parashikuar dhe aksidentale; Për çdo rast dëmi i siguruarit është i detyruar të paraqesë dokumentacionin për dëmshpërblim: **a)** njoftim kërkesë, **b)** dokumentacionin policor & prokurorisë për ngjarjen kur dëmi është mbi 50,000 lekë c) fotokopje të dokumentacionit të mjetit, "leje qarkullimi, fotokopje të policës kasko, fotokopje të lejes së drejtimit, fotot e mjetit të dëmtuar".

2. "SHTRIRJA TERRITORIALE"

a. Kjo kontratë është e vlefshme për dëmet që ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë; **b.** Siguruesi mund të zgjerojë shtrirjen territoriale të policës së Sigurimit, përkundrejt pagimit të një primi shtesë. Zgjerimi i shtrirjes territoriale nuk mund të kalojë kufijtë e kontinentit Evropian **ku do përjashtohen shtetet si Republika e Bosnje Hercegovinës dhe Bullgarisë për rastet e vjedhjes së mjeteve apo vjedhjes së aksesorëve të mjeteve.**

3. "PERIUDHA E SIGURIMIT"

a. Periudha e sigurimit është e përcaktuar në kontratë e cila është (1) njëvjeçare, përveç rasteve kur në policën e sigurimit përcaktohet ndryshe; **b.** Mbulimi në sigurim, hyn në fuqi në orën 24.00 të datës së përcaktuar si datë fillimi në kontratë, me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit, dhe përfundon në orën 24.00 të datës së përcaktuar.

4. "PRIMI I SIGURIMIT"

a. Primi i Sigurimit, "Tarifa" e cila përcaktohet

në bazë të llogaritjeve, sipas mbulimeve të zgjedhura, klasifikimit dhe veçorive të mjetit motorik, si dhe në bazë të Siguruarit dhe numrit të përdoruesve; **b.** Primi i sigurimit paguhet njëherësh, vlerë dhe kohë maturimi sipas përcaktimit paraprak të palëve dhe shënohet në kontratë. **c.** Pagesa, do të quhet e kryer, në momentin e kalimit të vlerës monetare të primit në llogarinë e **Siguruesit**; **d.** Nëse primi i sigurimit nuk është paguar në momentin e ndodhjes së ngjarjes të siguruar, kontrata është e pavlefshme;

5. MBULIMET E SIGURUARA DHE PËRJASHTIMET E VEÇANTA

5.1 "DËMTIMI AKSIDENTAL"

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik gjatë qarkullimit apo qëndrimit të tij nga: a. Përplasja ose përmbysja me një objekt fiks ose të lëvizshëm e mjetit motorik shkaktuar si pasojë e përgjegjesisë së drejtuesit të mjetit me cilësinë e të Siguruarit; **b.** Dëmtimi i mjetit kur ndodhet i parkuar në një vend të caktuar dhe nuk mund të identifikohet shkaktari i aksidentit. Dëmet të tilla përfshijnë, të gërvishturit me mjete të forta, njetosje apo shtypje të çdo pjesë të sipërfaqes së jashtme të mjetit, mbulimi i rasteve të dëmeve në parkim pa autor do të jetë deri në vlerën 50,000 lekë; **c.** Çdo rast dëmi aksidental, ku vlera e dëmit kalon vlerën 50,000 lekë, duhet të jetë i vërtetuar nga organet Policore ose Prokurorisë, në rast se i siguruarit nuk paraqet dokumentacionin policor apo të prokurorisë, pavarësisht madhësisë së dëmit, siguruesi paguan dëmin deri në vlerën 50,000 lekë.

5.2 "THYERJA E XHAMAVE"

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik nga: a. Plasaritja deri tek thërmimi i xhamave të përparme, të



pasëm, anësor, të tavaneve të lëvizshëm.

5.3 "ZJARRI, EKSPLOZIONI DHE RRUFEJA"

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik nga: **a.** Zjarri dhe Eksplozioni që vijnë nga faktorë të jashtëm që vetpërhapen dhe përfshijnë mjetin e siguruar, **këtu përjashtohen** dëmet që vijnë nga nga persona të paidentifikuar, janë të qëllimshme, ose shkaqe të brendshme të mjetit motorik si defekt teknik apo kur shkak ka qënë pirja e duhanit; **b.** Rrufeja që godet direkt mbi mjetin motorik;

5.4 "KATASTROFA NATYRORE"

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik nga: **a.** Stuhia, breshëri, dëbora, tufani, përmbytja, vërshimi, kur katastrofa natyrore është e njohur dhe e deklaruar si e tillë nga autoritetet përkatëse shtetërorë, **duke përjashtuar dëmet nga tërmeti, rrëshqitja e tokës, si dhe kalimi i mjetit të siguruar nëpër lumenj, përrenj apo futjen e tij në pellgje të mëdha uji;** **b.** Dëmet e shkaktuara në mjetin motorik të siguruar nga rënia e objekteve të ndryshme, që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore; **c.** Dëmet në mjetin motorik të siguruar, shkaktuar nga përmbytja e garazhit si rezultat i çarjes së tubacioneve të ujrave edhe në rast se nuk ka ndodhur katastrofë natyrore.

5.5 "VJEDHJA"

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik nga: **a.** Vjedhja: Do të konsiderohet veprimi i përvetësimit në mënyrë të fshehtë i mjetit motorik të siguruar (vjedhje totale) si dhe dëmet që pasojnë nga tentativa për vjedhje kallëzuar dhe vërtetuar nga organet e Rendit Publik & Prokurorisë të vendit ku ka ndodhur ngjarja, në rast vjedhje Siguruesi është i detyruar të paguajë 80% të vlerës së mjetit sipas çmimit të tregut të siguruar, brenda periudhës 90 ditore 50% të vlerës së dëmit me vërtetimin e ngjarjes nga organet e Prokurorisë, dhe

50% të vlerës së dëmit pasi të kenë mbaruar hetimet nga ana e organeve të Prokurorisë & Gjykatës me vendim të formës së prerë.

5.6 "VJEDHJA E PJESSHME"

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik nga: **a.** Vjedhja e Pjesshme: Do të konsiderohet vjedhja e pajisjeve/aksesorëve si (autoradio, kroskot, parakolp, airbag, sensor parkimi, televizor, sistem navigatori, antena, targat dhe dyert) si dhe dëmet që pasojnë nga tentativa për vjedhje të pjesshme të mjetit motorik të siguruar (vjedhje e pjesshme) të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore.

5.7 "AKTE KEQDASHËSE"

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit motorik nga: **a.** Dëmet e shkaktuara nga veprimet e dhunshme, të qëllimshme e të vullnetshme të individëve të motivuar nga dashakeqësia, që me zjarr, eksplozion ose mjete të tjera dëmtojnë ose shkatërrojnë mjetin objekt sigurimi përgjatë qarkullimit të tij (lëvizjes, ndalimit, qëndrimit) në rrugë;

5.8 "SIGURIMI I MJETIT MOTORIK PËR JASHTË TERRITORIT TË SHQIPËRISË"

a. Në Sigurimin e mjetit motorik për "Jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë" do të përfshihen mbulimet dhe përjashtimet sipas mbulimeve të përzgjedhura në policë nga i Siguruari dhe të vërtetuara me dokumentin e organeve të policisë apo prokurorisë, të vendit ku ka ndodhur ngjarja.

5.9 "MBULIMI I TRANSPORTIT ME KARROATREC"

Siguruesi do të mbulojë shpenzimet e transportit me karroatrec të mjetit motorik nga vendi i ngjarjes deri në vendin e përcaktuar nga siguruesi, vetëm për ato raste sipas përcaktimeve të pikës 5. dhe kur mjeti motorik nuk mund të lëvizë si pasojë e dëmtimeve të rënda;

6. "PËRJASHTIME ÇFARË NUK ËSHTË E





MBULUAR"

Siguruesi, nuk do të dëmshpërblejë, humbjet apo dëmtimet, që pëson mjete motorik, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekt, janë shkaktuar, rrjedhin ose janë rënduar gjatë, në ose nga:

- a.** Dëmet që rezultojnë nga çdo akt i luftës, invazionit, nga përdorimi i armëve të zjarrit, lufta civile, rebelimit, revolta, grushte shteti, akteve terroriste, trazirave, grevës, sabotimit;
- b.** Dëmet që i shkaktohen të Siguruarit nga mjete që janë të siguruar me sigurim TPL dhe me kontrata të tjera, të shoqërive të tjera. (ose jo, psh nga një mjet i pasiguruar etj);
- c.** Dëmet ose vjedhja totale apo e pjesshme e shkaktuara qëllimisht e nxitur ose i udhëzuar nga i Siguruari, familjarët dhe/ose punonjësit ose agjentët e tij;
- d.** Drejtuesi nuk e përdor mjetin në përputhje me qëllimin për të cilin ai është i destinuar të përdoret, nuk ka leje të vlefshme të drejtimit të mjetit motorik sipas kategorisë apo tipit të mjetit bazuar në (Kodin Rrugor Neni 114, 115 dhe 115/1), i është tërhequr ose pezulluar nga autoriteti kompetente leja e drejtimit të mjetit në momentin që ndodh ngjarja e sigurimit, dhe përdor leje drejtimi të lëshuar nga një shtet tjetër;
- e.** Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi nga Organet e Shtetit;
- f.** Dëmet që shkaktohen nga përdorues emrat e të cilëve nuk janë shënuar në policë;
- g.** Dëmet kur mjeti ka ndërruar pronësi dhe kasko është me pronësinë e vjetër, ose kur mjeti ka ndërruar targë dhe nuk ka bërë dublikatën kundrejt tarifës së caktuar;
- h.** Prerja apo skopjimi i gomave, por jo dëmet që pasojnë;
- i.** Dëmet e shkaktuara kur drejtuesi i mjetit ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit ose përdorimit të lëndëve narkotike;
- j.** Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në mjet në momentin e rastit të sigurimit;
- k.** Siguruesi nuk do të mbulojë zmadhimin e

humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhencës të të Siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese që të mos thellohen ato (psh: parkimi në vende ku rrezikohet zmadhimi i dëmit, drejtimi i mjetit pasi është aksidentuar, dhe kur mjeti sinjalizon anomali;

- l.** Dëmet kur drejtuesi i mjetit largohet nga vendi i aksidentit duke mos pritur organet e Policisë për zbardhjen e ngjarjes, ose kur ai njofton Organet Policore, dhe paraqitet në një kohë më të vonë se ndodhja e aksidentit, për kryerjen e procedurave me Organet Policore;
- m.** Dëmet që shkaktohen kur mjeti qarkullon jashtë rruge apo vende të cilat nuk quhen rrugë sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor; si dhe futjen e mjetit në pellgje uji, lumenj, apo dëme që vijnë nga tërmeti dhe rrëshqitjet e tokës;
- n.** Dëmet që pasojnë nga shpejtësia e lartë (+30km/h) mbi kufijtë e lejuar nga sinjalistika rrugore ose kodi rrugor;
- o.** Dëmet e shkaktuara nga, lëndët e rrezikshme apo kafshët që transportohen me këtë mjet;
- p.** Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për vjedhjen totale të mjeteve apo pajisjeve/aksesorëve në vende të cilat janë të përjashtuara për rastet e vjedhjes sipas kësaj kontrate.
- q.** Vjedhjen e Pajisjeve apo aksesorëve të jashtëm dhe të brendshëm të mjetit si: pasqyra, autoradio, antenna, telefon, autoparlante, fshirëse xhamash, kroskot, parakolp, dyer, airbag, televizor, sisteme navigator, sensor parkimi, tasa të gomave, gomat, disqet e gomave, targat e mjetit motorik, e të ngjashme me to.
- r.** Vjedhjen e mjetit me dhunë që nënkupton përdorimin e armëve, imitacioneve të tyre apo dhe mjete të tjera të dhunës nga persona të identifikuar apo të paidentifikuar të cilët venë nën kërcënim jetën dhe shëndetin e zotëruesit të mjetit me cilësinë e të Siguruarit.
- s.** Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për humbjen apo dëmtimin e mjeteve të cilat rezultojnë të vjedhura më





parë jashtë territorit të Shqipërisë. **t.** Fitimin e munguar; **u.** Dëmet e shkaktuara mjetit motorik të siguruar që synojnë shkatërrimin e pronës me zjarr apo eksploziv të qëllimshëm apo me mjete të tjera dhe të cilat konsiderohen e trajtohen si "Akte Keqdashëse" dhe kur në Policë nuk është e mbuluar nga Aktet Keqdashëse; **v.** Dëmet nga vjedhja totale, vjedhja e pjeshme ose tentativë vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyert, tavani i lëvizshëm, xhamat ose çelësat e mbylljes janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij, kur mjeti është parkuar në rrugë të paiventarizuara sipas kushteve të përgjithshme të sigurimit KASKO. Në rastin e ndodhjes së kësaj ngjarje sigurimi, i Siguruari është i detyruar t'i dorëzojë Siguruesit të gjitha kopjet e çelësave. Gjithashtu, i Siguruari duhet të deklarojë çdo humbje të çelësit të makinës tek Siguruesi, në rast të kundërt Siguruesi nuk mban përgjegjësi për rastin e sigurimit. **w.** Riparimi i dëmëve për mjete të modifikuara nga poseduesi i tij si **(body kit, veshje adeziv, qeramik, film ppf, lyer ngjyre mat)**. Riparimi ose zëvendësimi i mjeteve të modifikuara kryhet vetëm me pjesë këmbimi sipas të dhënave që tregojnë sistemet përkatëse të koncensionarëve të mjeteve sipas markave dhe nga numri i shasisë së mjetit. **x.** Dëmet që i shkaktohen mjetit motorik në qarkullim kur drejtohet nga një përdorues tjetër i ndryshëm nga i/të Siguruari/it e shënuar në policë. **y.** Dëmet në mjetin motorik të siguruar, si rezultat i konsumit normal, defekteve apo avarive të brendshme elektrike apo mekanike të mjetit që është neglizhuar në riparimin e tyre. **z.** Dëmet në çdo xham tjetër që nuk përfshihet në katalogun e prodhimit, por që është vendosur si aksesori në mjetin motorik, si dhe dëmet në mbulesat ose perdet mbrojtëse nga dielli të montuara në xhama nga vetë i Siguruari;

7. "POLICA E SIGURIMIT"

a. Siguruesi, i dorëzon të Siguararit, Policën e Sigurimit, e cila vërteton, pranimin e Kushteve të Përgjithshme nga i Siguruari si dhe lidhjen e Kontratës së Sigurimit; **b.** Polica e sigurimit, lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim ose me email të të Siguararit "Pyetësori". Siguruesi, lëshon Policën e Sigurimit dhe përcakton primin e sigurimit, në bazë të njoftimeve dhe deklarimeve të bëra nga i Siguruari; **c.** I Siguruari, është përgjegjës, për vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të bëra prej tij; **d.** Kur, Polica e Sigurimit, humbet ose dëmtohet, në masën që bëhet e pavlefshme, me kërkesën dhe shpenzimet e të Siguararit, Siguruesi, duhet të lëshojë një dublikatë të saj; **e.** Kur, gjatë periudhës së sigurimit është përfituar dëmshpërblim nga kjo Policë sigurimi, polica nuk mund të kthehet për pjesën e mbetur të periudhës së sigurimit dhe as të dublikohet në rastet kur ka ndryshuar pronësia apo përdoruesit; **f.** Kalimi i të Drejtave. Të drejtat dhe detyrimet e të Siguararit në këtë kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Ky miratim do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në kontratën e sigurimit. Çdo parashikim apo pretendimin i ndryshëm me parashikimin e paragrafit të parë të kësaj pike është i pavlefshëm dhe e çliron Siguruesin nga detyrimi për mbulim në sigurim;

8. "TË DREJTA DHE DETYRIME"

a. I Siguruari, është i detyruar të paguajë primin e sigurimit sipas dakortësisë mes palëve; **b.** I Siguruari duhet të njoftoj menjëherë Siguruesin për ndodhjen e rastit të sigurimit, jo më vonë se 48 orë nga momenti i ndodhjes së ngjarjes së sigurimit ose marrjes në dijeni për ndodhjen e saj; **c.** Në pajtim me natyrën e ngjarjes së sigurimit të njoftojë menjëherë, brenda 24 orësh, organin kompetent, si Policinë Rrugore (për Aksidentet), Policinë e Rendit (për vjedhjen)





dhe PMNZSH (për rënien e zjarrit), si dhe t'i paraqesë Siguruesit vërtetimet e këtyre organeve për njoftimet apo denoncimet e kryera; **d.** I Siguruari, në rastin e dëmtimeve në parkim pa autor ose dëmet aksidentale, kur vlera e dëmit tejkalon vlerën prej 50,000 lekë duhet të njoftojë organet kompetente dhe të pajiset me proces verbal Policie; **e.** Për çdo rast dëmi Siguruesi, do të zbresë nga shpërblimi i llogaritur, Pjesën e Zbritshme të përcaktuar në kontratë për dëmin e parë 10%, për dëmin e dytë 20% dhe mbi 3 dëme pjesa e zbritshme që paguan klienti do të jetë 30%, e cila është ajo pjesë e dëmit që përballohet nga klienti; **f.** Siguruesi, ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit brenda 30 ditëve nga fillimi i saj, për shkak të pasaktësisë së informacionit të dhënë nga i Siguruari; **g.** Siguruesi, ka të drejtë, nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit, ose të zgjidhë kontratën; **h.** Siguruesi, gëzon të drejtën të çlirohet nga detyrimet e tij për dëmshpërblim nëse i Siguruari, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton detyrimet e tij; **i.** Siguruesi, ka të drejtë, të verifikojë rrethanat në të cilat ka ndodhur Rasti i Sigurimit, si edhe të kryejë ekspertizën e dëmit apo të humbjeve në mjetin motorik të siguruar, brenda 15 ditësh nga dita e njoftimit të ngjarjes së sigurimit. Gjatë kësaj periudhe, i Siguruari, është i detyruar të mbajë mjetin motorik të dëmtuar në dispozicion të Siguruesit, pa e riparuar atë; **j.** Siguruesi, në varësi të dëmit, përcakton formën e dëmshpërblimit si: (Pagesë e vlerës së dëmit, Riparim i mjetit të dëmtuar, në pikën e riparimit të ofruar nga Siguruesi ose Zëvendësim i mjetit të dëmtuar, me një mjet tjetër analog), vlerësimi i dëmit ose zëvendësimi i pjesëve të këmbimit do të bëhet gjithmonë sipas të dhënave që tregojnë sistemet përkatëse të koncensionarëve të mjeteve sipas markave,

nga numri i shasisë së mjetit; **k.** Siguruesi, mund të shtyjë kohën e pagesës, për atë kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguarit, për të marrë pagesën, në qoftëse, janë filluar hetime penale, në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Siguarit, për atë kohë sa, i Siguruari, nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi; **l.** Siguruesi, ka të drejtë që kur vlera e dëmit, është më e lartë se 80% e shumës së siguruar, mjeti motorik do të konsiderohet dëm total, dëmi total do t'i paguhet të Siguarit nga Siguruesi sipas vlerës së tregut të mjetit në momentin e ngjarjes duke i zbritur 20% si vlerë e mbetur për pjesët e mjetit e dëmtuar (referencë norma e amortizimit sipas ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998, neni 22) dhe pjesën e zbritshme sipas kontratës kasko; **m.** Në rast pagese dëmshpërblimi në kundërshtim me kushtet e kësaj police, Siguruesi, gëzon të drejtën e Përfituesit/të Siguarit, për të kërkuar kthimin e shumës/të drejtave pasurore, ose të çdo të drejtë tjetër legale, ndaj çdo personi ose subjekti përgjegjës për aksidentin; **n.** Siguruesi, ka të drejtë aplikimin për rinovimet e kontratave të cilat kanë përfituar dëmshpërblim (MALUS) që nënkupton rritje primi 15%. Si dhe, për kontratat që nuk kanë përfituar dëmshpërblim të aplikojë (BONUS) që nënkupton zbritje në masën 10% të primit; **o.** Në çdo kërkesë, padi ose procedurë tjetër gjyqësore ku Siguruesi deklaron se, sipas parashikimeve të mësipërme, humbja apo dëmtimi nuk mbulohet në sigurim, barra për të provuar që kjo humbje, shkatërrim, dëmtim apo përgjegjësi mbulohet, do t'i takojë të Siguarit;

9. "SHUMA E SIGURUAR"

a. Mjeti motorik, i treguar në policën e sigurimit, mbulohet në sigurim, për një shumë të siguruar, e cila përcaktohet në marrëveshje midis Siguruesit dhe të





Siguararit; b. Shuma e siguar, mund të jetë e barabartë me vlerën e blerjes së mjetit motorik të ri, kur ky merret në sigurim në momentin e vënies në qarkullim për herë të parë, ose me vlerën e tregut; **c. Për çdo rast dëmshpërblimi**, i siguari duhet të rivendosë Shumën e Sigurimit kundrejt një Primi Shtesë, në të kundërt trajtimet për ngjarjet e siguara deri në përfundim të kontratës/Policës së sigurimit do të trajtohen me kushtet e Nën sigurimit; **d.** Në rast se, të dy palët bien dakord, që shuma e siguar të jetë më e vogël se vlera e tregut të mjetit motorik, do të kemi nën sigurim dhe do të zbatohen procedurat e seksionit "Nën sigurimi";

10. "NËNSIGURIMI"

a. Siguruesi dhe i Siguari, mund të bien dakord për sigurimin e mjetit motorik për një **Shumë Sigurimi** më të vogël se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorik të ri; Në këtë rast, dëmshpërblimi që do të përfitojë i **Siguarit**, do të llogaritet duke shumëzuar, vlerën e dëmit me koeficientin e nën sigurimit. Koeficienti i nën sigurimit, është raporti i shumës së siguar kundrejt vlerës së tregut apo të blerjes së mjetit motorik të ri; **b.** Nën sigurimi, do të zbatohet, edhe nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, shuma e siguar, është më e ulët se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorik të ri;

11. "MBISIGURIMI"

a. Nëse, Shuma e Siguar, është përcaktuar më e lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit mjet të ri, **Siguruesi dhe i Siguari**, kanë të drejtë të bëjnë ndryshimet përkatëse në Policën e Sigurimit, duke zvogëluar si Shumën e Siguar ashtu dhe Primin e Sigurimit; **b.** Në çdo rast, kufiri i përgjegjësisë së **Siguruesit**, nuk do të jetë më i lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit tip mjet motorik, duke zbritur pjesën e zbritshme; **c.** Nëse, i **Siguarit**, lidh

kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. **Siguruesi**, ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit;

12. "PËRFUNDIMI I POLICËS SË SIGURIMIT"

Kontrata e sigurimit, është e pavlefshme, nëse vërtetohet se, rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar ose ka pushuar së qeni para lidhjes së kontratës; **Siguruesi do të zgjidhë kontratën e sigurimit në qoftë se: a.** Nuk është paguar kësti vijues i primit të sigurimit, ose primi i sigurimit për kontratat e rinovuara. Data e zgjidhjes do të jetë 15 ditë pas mbarimit të afatit të pagimit; **b.** Ka të dhëna për pasaktësi të informacionit të dhënë nga i **Siguarit**; **c.** Me shqyrtimin e kërkesës për dëmshpërblim, të paraqitur nga i **Siguarit**, **Siguruesi**, ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit, duke i kthyer të **Siguarit**, pjesën e primit, në përputhje me tabelën e kthimit të primit. **Siguruesi**, mund të zgjidhë kontratën (kontratat) për një ose disa mjete të të njëjtit të **Siguarit**; **d.** Kur pas lidhjes së kontratës të sigurimit pushon interesi pasuror i të Siguarit (transferohet pronësia), kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur;

13. "I SIGUARIT MUND TA ZGJIDHË KONTRATËN"

a. Duke njoftuar 30 ditë përpara datën e zgjidhjes; **b.** Kur të Siguarit ose përdoruesit të mjetit motorik i është hequr dëshmia e aftësisë gjatë muajve të fundit;

14. "ZGJIDHJA MOSMARRËVESHJEVE"

Mosmarrëveshjet midis Siguruesit dhe të Siguarit kur nuk zgjidhen me mirëkuptim zgjidhen nga Gjykata e vendit ku është lidhur Kontrata e Sigurimit.

